



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

19.12.2020

Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, penale, legjislacionin tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit liqor të pasqyrave financiare.

TEZA 4

ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)

1. Vendimet e këshillit të administrimit, te sistemi me një nivel, vlerësohen të vlefshme:

- a) Kur anëtarët janë njohur me rendin e ditës 3 ditë para mbledhjes;
- b) Kur vendimi i marrë nuk kundërshtohet nga anëtarët jo të pranishëm;
- c) Kur miratohen nga kryetari i këshillit të administrimit;
- d) Kur janë të pranishëm tre të katërtat e anëtarëve;
- e) Kur janë të pranishëm një e treta e anëtarëve;
- f) Kur janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve;
- g) Pas regjistrimit në QKB;
- h) Alternativat "a" e "b".

Pergjigja e sakte alternativa (E)

2. Dy shoqëri mund të bashkohen duke themeluar një shoqërie të re:

- a) Tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese;
- b) Procesi quhet bashkim me përthithje;
- c) Vetëm pasi të shprehet gjykata;
- d) Që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re;
- e) Edhe kur janë shoqëri kolektive;
- f) Brenda një afati prej 30 ditësh nga marrja e vendimit të bashkimit;
- g) Që do të ketë formën e shoqërisë komandite;
- h) Alternativat "a" e "d".

Pergjigja e sakte alternativa (H)

3. Kanë të drejtë për të kundërshtuar një vendim të mbledhjes së kreditorëve, brenda 5 ditëve nga bërja publike e vendimit:

- a) Administratori i falimentimit;
- b) Administratori mbikëqyrës;
- c) Kreditorët fundorë;
- d) Ortakët;
- e) Alternativa a) dhe b);
- f) Alternativa b) dhe c);

- g) Alternativa c) dhe d);
- h) Alternativat a), b), c) dhe d).

Pergjigja e sakte alternative (E)

4. Së bashku me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit, cilin nga dokumentacioni dhe informacioni në vijim paraqet debitori:

- a) Ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;
- b) Raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë pagueuse dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit;
- c) Bilancin dhe pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të aktivitetit të debitorit;
- d) Listën e pronave të paluajtshme dhe të luajtshme;
- e) Listen e bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;
- f) Listen e procedurave ligjore ku debitori është palë e paditur;
- g) Alternativat nga a) deri në e);
- h) Të gjitha alternativat.

Pergjigja e sakte alternative (H)

5. Në cilin nga llojet e mëposhtme të sigurimeve nuk kontribuon punëdhënësi:

- a) Sëmundjet profesionale;
- b) Aksidentin në punë;
- c) Papunësinë
- d) Barrëlindjen;
- e) Pleqërinë;
- f) Invaliditetin;
- g) Humbjen e mbajtësit të familjes;
- h) Asnjë nga të mësipërmet.

Pergjigja e sakte alternative (H)

6. Punëdhënësi mund të kërkojë zbatimin e marrëveshjes për ndalimin e konkurrencës:

- a) nëse i ofron punëmarrësit, gjatë periudhës së ndalimit, jo më pak se 75 për qind të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte të punonte për punëdhënësin;
- b) Nëse i ofron punëmarrësit, gjatë periudhës së ndalimit, jo më pak se 50 për qind të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte të punonte për punëdhënësin;
- c) Kundrejt asnjë shpërblimi, nëse një ndalim i tillë është parashikuar qartë në kontratë;
- d) Nëse punëmarrësi punësohet te kompanitë që ushtrojnë aktivitet të ngjashëm;
- e) Deri në tre vite nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës;
- f) Pa afat;
- g) Në cdo moment.

Pergjigja e sakte alternative (A)

7. Zotësinë për të vepruar e ka:

- a) Cdo individ, që nga momenti i lindjes;
- b) Personi që mbush moshën 16 vjeç;
- c) Personi që mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç;
- d) Gruaja e martuar edhe pa mbushur moshën 18 vjeç;
- e) Alternativa a) dhe b);
- f) Alternativa b) dhe c);
- g) Alternativa c) dhe d);
- h) Alternativa a), b), c) dhe d).

Pergjigja e sakte alternative (G)

8. Bankë korrespondente është

- a) Një bankë, e cila nuk ka prani fizike, përfshirë mungesën e administrimit e drejtimit, si dhe nuk është e përfshirë në një grup të rregulluar financiar;
- b) Tërësia e shërbimeve bankare/financiare të ofruara nga një bankë për një bankë tjetër (banka pritëse);
- c) Banka që përfiton shërbime bankare nga një bankë tjetër ose klientë të saj, në bazë të një marrëveshjeje ose marrëdhënieje kontraktuale të lidhur ndërmjet tyre;
- d) Banka që ofron shërbime bankare për llogari të një banke tjetër (banka iniciuese) ose klientëve të saj, të një bankë e tretë (banka pritëse), në bazë të një marrëveshjeje ose marrëdhënieje kontraktuale të lidhur ndërmjet tyre;
- e) Banka që ofron shërbime bankare të një bankë tjetër (banka pritëse), në bazë të një marrëveshjeje ose marrëdhënieje kontraktuale të lidhur ndërmjet tyre;
- f) Banka që ofron shërbime bankare, tek klientët e saj, për llogari të një banke tjetër (banka iniciuese), në bazë të një marrëveshjeje ose marrëdhënieje kontraktuale të lidhur ndërmjet tyre;
- g) banka që vepron për të tretë për llogari të një banke tjetër (banka iniciuese) ose klientëve të saj, në bazë të një marrëveshjeje ose marrëdhënieje kontraktuale të lidhur ndërmjet tyre;
- h) Banka që ofron shërbime bankare për llogari të një banke tjetër (banka iniciuese) ose klientëve të saj, të një bankë e tretë (banka pritëse), kur një gjë e tillë përcaktohet në ligj;

Pergjigja e sakte alternative (D)

9. Në kuadrin e ushtrimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, subjektet duhet:

- a) Të identifikojnë klientin (të përhershëm apo rastësor, person fizik, juridik apo organizime ligjore) dhe të verifikojnë identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura;
- b) Të identifikojnë pronarin përfitues dhe të marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij, nëpërmjet informacioneve ose të dhënave të siguruar nga burime të besueshme, në bazë të të cilave subjekti sigurohet për identitetin e tij;
- c) Të përcaktojnë për të gjithë klientët, para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit, nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër, dhe të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin dhe verifikimin e atij personi;

- d) Të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit për klientët që janë persona juridikë apo organizimet ligjore;
- e) Të mbledhin informacion për qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit dhe të zhvillojnë profilin e riskut gjatë monitorimit të vazhdueshëm;
- f) Të mos hapin apo të mos mbajnë llogari anonime, me emra fiktivë ose të identifikuar vetëm nëpërmjet një numri apo kodi, përfshirë depozitat apo instrumentet e tjera të mbajtesit. Nëse ka llogari të tilla, klientët e tyre duhet të identifikohen dhe të verifikohen, sipas parashikimeve të këtij neni. Nëse kjo nuk arrihet, llogaria duhet të mbyllet dhe t'i dërgohet raport për aktivitet të dyshimtë "autoritetit përgjegjës".
- g) Të sigurohen, nëpërmjet rishikimit të dosjeve të klientëve, që dokumentet, të dhënat dhe informacioni i mbledhur gjatë procesit të vigjilencës së duhur janë përditësuar, janë të vlefshme dhe të përshtatshme, veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit që kategorizohen me risk të lartë;
- h) Të plotësojnë detyrimet e sipërpërmendura edhe për klientët ekzistues, duke u bazuar në prova, fakte dhe rrezikun e ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Pergjigja e sakte alternative (F)

10. Konform ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" subjektet duhet të identifikojnë klientët dhe të verifikojnë identitetin e tyre me anë të dokumenteve të identifikimit:

- a) Para se të vendosin një marrëdhënie biznesi;
- b) Kur klienti kryen ose kërkon të kryejë- një transfertë të drejtpërdrejtë brenda ose jashtë vendit në një shumë të barabartë ose më të madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja;
- c) Kur ka dyshime për vërtetësinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë;
- d) Kur ka të dhëna ose dyshime të mjaftueshme për pastrim parash ose financim të terrorizmit;
- e) Alternativa a) dhe b);
- f) Alternativa b) dhe c);
- g) Alternativat b), c) dhe d);
- h) Alternativat a), b), c) dhe d);

Pergjigja e sakte alternative (H)

PYETJE ME SHTJELLIM (10 x 4 pikë)

1. Flisni për përbërjen e këshillit të administrimit (sistemi me një nivel).

Përgjigje:

- 1. Këshilli i administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.*
- 2. Anëtarët e këshillit të administrimit zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e pjesëmarrësve, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të rizgjidhen.*
- 3. Statuti mund të parashikojë që aksionarët, të cilët zotërojnë së bashku një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5% ose një vlerë më të vogël të kapitalit të regjistruar, të kenë të drejtën të emërojnë një anëtar të këshillit të administrimit me një vendim të posaçëm. Anëtarët e zgjedhur në këtë mënyrë nuk mund ta rrisin numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit mbi numrin maksimal prej 21 anëtarësh.*
- 4. Anëtarë të pavarur të këshillit të administrimit vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash, sipas ligjit për shoqëritë tregtare. (neni 155).*

2. Çfarë është shoqëria komandite. Llojet e ortakëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Përgjigje:

Shoqëri komandite është shoqëria, në të cilën përgjegjësia e të paktën njërit prej ortakëve është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, ndërsa përgjegjësia e ortakëve të tjerë nuk është e kufizuar.

Ka dy lloje ortakësh, të kufizuar dhe pakufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i kufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit nuk është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i pakufizuar. Ortaku i pakufizuar ka statusin e ortakut të shoqërisë kolektive.

Ortakët kanë dallime midis tyre, përsa i përket ushtrimit të së drejtës së administrimit, përfaqësimit, apo përballimit të humbjeve:

- a) Veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite administrohet nga një ose më shumë ortakë të pakufizuar. Ortakët e kufizuar nuk kryejnë veprime administrimi;*
- b) Ortaku i kufizuar nuk mund të veprojë si përfaqësues ligjor i shoqërisë komandite.*
- c) Ortaku i kufizuar përballon humbjet e shoqërisë deri në vlerën e pjesës së tij në kapital dhe vlerën e kontributeve ende të pashlyera. Marrëveshjet ndërmjet ortakëve, që përjashtojnë ortakun e kufizuar nga detyrimi për të shlyer kontributet, apo që shtyjnë afatin e shlyerjes së këtyre kontributeve, nuk prodhojnë efekte ndaj kreditorëve.*

3. Cilat janë rastet e pezullimit të aplikimit për regjistrim nga QKB-ja?

Përgjigje:

Në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 54, të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 'Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit', i ndryshuar, rezulton se:

- o nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim,*

- nuk janë paguar tarifat përkatëse të regjistrimit,
- ka sanksione administrative të papaguara apo
- nuk janë kryer regjistrimet e kërkuara, sipas nenit 46 të këtij Ligji,

QKB-ja pezullon aplikimin dhe e njofton aplikuesin me shkrim për shkakun e saktë të pezullimit, duke i dhënë një afat prej 21 ditësh kalendarike për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin.

Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari standard të QKB-së.

4. Cilat janë kufizimet e debitorit në administrimin dhe disponimin e masës së falimentimit në rastet kur procedura e falimentimit nis me kërkesë të tij?

Pergjigje:

Në rastet kur procedura e falimentimit nis me kërkesë të debitorit, të drejtat e administrimit e të disponimit të masës së falimentimit do të vazhdojnë të jenë nën autoritetin e debitorit me kufizimet e mëposhtme:

- a) të drejtat e debitorit do të jenë të kufizuara në veprime të administrimit të zakonshëm dhe janë objekt i kontrollit të përgjithshëm nga administratori mbikëqyrës;*
- b) administratori mbikëqyrës autorizon paraprakisht të gjitha veprimet e disponimit që janë jashtë fushës së veprimtarisë së zakonshme të biznesit ose që nuk përbëjnë vepra të ruajtjes së thjeshtë të pasurisë. Çdo posedim i pasurive, që janë objekt i të drejtave të siguruara, konsiderohet si një veprim jashtë veprimtarisë së zakonshme të aktivitetit të debitorit;*
- c) debitori nuk mund të kryejë veprime që janë brenda veprimtarisë normale të biznesit, të cilat në mënyrë të qartë janë kundërshtuar nga administratori mbikëqyrës;*
- ç) administratori mbikëqyrës ose çdo kreditor mund të kërkojë në çdo kohë nga gjykata e falimentimit heqjen tërësisht ose pjesërisht të të drejtave të administrimit e të disponimit të debitorit.*

Kjo kërkesë duhet të justifikohet sipas rregullave dhe të bazohet në ekzistencën e rrezikut ndaj pasurisë dhe interesit të kreditorëve.

5. Si e përcakton Kodi i Punës transferimin e ndërmarrjes. Të drejtat dhe detyrimet e palëve, zgjidhja e kontratës.

Pergjigje:

Me transferim të ndërmarrjes ose të një pjese të saj kuptohet transferimi i njësisë ose pjesës ekonomike, e cila ruan identitetin, në kuptimin e të qenit një grup i organizuar burimesh, që ka për qëllim kryerjen e një veprimtarie ekonomike, pavarësisht nëse kjo veprimtari është kryesore ose ndihmëse.

Në rast transferimi të ndërmarrjes ose një pjese të saj, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tij, në bazë të një kontrate pune që është në fuqi deri në momentin e transferimit, i kalojnë personit që i transferohen këto të drejta. Punëmarrësi, edhe kur kundërshton të ndryshojë punëdhënësin, mbetet i lidhur me punëdhënësin e ri, deri në përfundim të afatit ligjor të njoftimit.

Transferuesi i të drejtave përgjigjet krahas atij që i merr këto të drejta, për detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, deri në përfundim të afatit kontraktual të njoftimit ose afatit të përcaktuar me kontratë individuale.

Pushimi nga puna i punëmarrësit nga punëdhënësi, për arsye të transferimit të ndërmarrjes, është i pavlefshëm. Bëjnë përjashtim pushimet që ndodhin për arsye ekonomike, teknologjike ose strukturore, që

kërkojnë ndryshime në planin e punësimit. Në këtë rast, pushimet duhet të respektojnë rregullat e përcaktuara në lidhje me njoftimin.

6. Si e rregullon Kodi i Punës punësimin e përkohshëm nga Agjencia. Të drejtat edhe detyrimet e palëve.

Pergjigje:

Punësim i përkohshëm nga Agjencia do të konsiderohet periudha kur një punëmarrës kontraktohet nga Agjencia për t'u punësuar përkohësisht nga një ndërmarrje pritëse, me kusht që midis Agjencisë dhe punëmarrësit të ketë një marrëdhënie kontraktore punësimi.

Gjatë periudhës së punësimit të një punëmarrësi të Agjencisë, të drejtat e detyrimet e punëdhënësit ushtrohen bashkërisht nga Agjencia dhe ndërmarrja pritëse, sipas kushteve të mëposhtme:

a) të drejtën e zgjidhjes së kontratës së punës e ka punëmarrësi dhe Agjencia.

b) pagat dhe përfitimet e tjera të punëmarrësit paguhen nga Agjencia.

c) të gjitha detyrimet që kanë të bëjnë me deklaratimet në organet tatimore, konfidencialitetin e të dhënave personale, si dhe zbritjet nga paga, lidhur me tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e

sigurimeve shoqërore e shëndetësore të punëmarrësit janë përgjegjësi e Agjencisë;

ç) përveçse kur është rënë dakord ndryshe, Agjencia mbulon të gjitha shpenzimet e lidhura me punësimin;

d) për kohëzgjatjen e punësimit, ndërmarrja pritëse konsiderohet punëdhënëse, në kuptimin e rregullimeve, lidhur me: (i) shëndetin dhe sigurinë në punë; (ii) parimin e trajtimit të barabartë; (iii) kohën e punës dhe të pushimit; (iv) dhënien e urdhrave dhe udhëzimeve punëmarrësit;

dh) ndërmarrja pritëse nuk ka të drejtë ta urdhërojë punëmarrësin të punojë te një punëdhënëse tjetër;

h) për çdo dëm që i shkaktohet punëmarrësit, gjatë periudhës së punësimit, ndërmarrja pritëse dhe Agjencia mbajnë përgjegjësi të përbashkëta dhe të veçanta në marrëveshje midis tyre;

7. Specifikoni shumën e pensionit familjar që akordohet sipas Ligjit për Sigurimet Shoqërore.

Përgjigje:

a) 50 për qind për personin e ve dhe

b) 25 për qind për çdo jetim ose persona të tjerë që përfitojnë.

Kur nuk merret pensioni i parashikuar nga shkronja "a", masa e pensionit për jetimin është 50%, kur ai është ose mbetet vetëm pjesëtar në pension. Kur pjesëtarë në pension janë më shumë se një jetim, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%.

Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes.

8. Konform dispozitave të Kodit Civil, cilat janë format e kontratës së sigurimit (si bëhet) dhe çfarë tregohet në dëshminë e sigurimit.

Përgjigje:

Kontrata e sigurimit duhet të bëhet me shkresë, me anë të dëshmisë të sigurimit (policës së sigurimit) që siguruesi i lëshon të siguruarit, përndryshe është e pavlefshme.

Në dëshminë e sigurimit të tregohen sidomos:

- a) emri i siguruesit;*
- b) emri i personit të siguruar, në rastin e sigurimit të personit, pasuria e siguruar dhe vendi ku ndodhet kjo pasuri në rastin e sigurimit të pasurisë;*
- c) ngjarja me vërtetimin e së cilës siguruesi të përmbushë detyrimin që ka marrë në kontratë;*
- d) fillimi dhe mbarimi i kontratës së sigurimit (afati i sigurimit);*
- e) koha nga e cila fillon përgjegjësia e siguruesit;*
- f) vlerësimi i pasurisë në ato raste që kjo gjë kërkohet për një lloj të caktuar sigurimi;*
- g) primet e sigurimit dhe afatet e pagimit të tyre.*

Kur sipas ligjit ose sipas kontratës shpërblimi i sigurimit ose shumat e sigurimit duhet t'i paguhet jo vetëm të siguruarit, por edhe një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, ky kusht duhet të tregohet në dëshminë e sigurimit

9. Sqaroni kuptimin dhe dallimin midis degës, filialit, dhe zyrës së përfaqësimit.

Përgjigje:

- 1. Sipas ligjit për shoqëritë tregtare, degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë. Pra, dega është një entitet i krijuar nga shoqëria mëmë që nuk ka personalitet të vetin juridik dhe nuk ka kapital të regjistruar të vetin. Dega mund të veprojë në emër të vetin apo të mëmës, por në cdo rast detyrimet e marra përsipër konsiderohen detyrime të shoqërisë mëmë. Përsa i përket çështjeve të aspektit struktural dhe organizativ dega ngjan me një shoqëri të pavarur.*
- 2. Filiali nuk përkufizohet nga ligji aktual për shoqëritë tregtare, por ka qenë koncept i rregulluar nga ligji i shfuqizuar dhe për këtë arsye ne e hasim shpesh si terminologji. Në këtë pikë, ligji aktual i referohet konceptit të shoqërië së kontrolluar. Pra, filiali është një shoqëri e krijuar nga një shoqëri tjetër, e cila kontrollon vendimarrjen e filialit. Filiali, ashtu si edhe shoqëria e kontrolluar, ka personalitet të pavarur juridik. Ato themelohen si një nga format e shoqërive, me kapital të vetin dhe pavarësi ekonomike.*
- 3. Zyrat e përfaqësimit janë vende të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë (pa personalitet juridik të sajin). Zyrat e përfaqësimit nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave (pra zhvillimin e aktivitetit ekonomik), por r nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë. Këto zyra mund të lidhin marrëveshje me palë të treta në emër të shoqërisë që përfaqësojnë, por këto zakonisht janë marrëveshje paraprake bashkëpunimi. Marrëveshjet e mirëfillta, me pasoja ekonomike, duhet të lidhen nga vetë shoqëria mëmë, e cila ka personalitet juridik dhe tagra për të marrë detyrime ndaj të tretëve.*

10. Konform dispozitave të Kodit Penal, cilat veprime konsiderohen - vepra penale në fushën e falimentimit.

Përgjigje:

Bazuar në Seksionin IX të Kodit Penal, konsiderohen vepra penale në fushën e falimentimit:

- a) Falimentimi i provokuar. Çuarja me dashje e personit juridik në gjendjen e falimentimit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*
- b) Fshehja e gjendjes së falimentimit. Hyrja në marrëdhënie ekonomike tregtare me të tretët nga ana e personit juridik, me qëllim të fshehë gjendjen e falimentimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.*
- c) Fshehja e pasurisë pas falimentimit. Fshehja e pasurisë pas falimentimit të personit juridik, me qëllim që t'u shmanget pasojave të tij, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.*
- d) Shkelja e detyrimeve. Shkelja nga ana e personit juridik të detyrimeve që rëndojnë mbi të me rastin e falimentimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet*

USHTRIME (10 x 5 pike)

Ushtrimi 1

A dhe B janë ortakë të shoqërisë "Y" SHPK. A zotëron 49% të kapitalit të shoqërisë, ndërsa B zotëron 51% i cili është njëkohësisht dhe administratori dhe përfaqësuesi i vetëm i shoqërisë. Në dt. 02.02.2014 asambleja e përgjithshme do të mbledhet për të diskutuar për gjendjen financiare.

Ortaku A i kërkon administratorit ti vejë në dispozicion dokumentacionin ekzistues mbi aktivitetin e shoqërisë. B i përgjigjet A duke u shprehur se dokumentacionin mund të vijë ta shqyrtojë në selinë e shoqërisë dhe më pas në dt. 27.01.2014 e njofton mbi zhvillimin e mbledhjes më dt. 02.02.2014.

Në përfundim të mbledhjes dhe vetëm me votat e ortakut mazhoritar, Asambleja e ortakëve vendos për përjashtimin e ortakut A nga shoqëria sipas nenit 102 të ligjit nr.9901/2008, pasi sjelljet e këtij ortakut kanë penguar veprimtarinë normale të shoqërisë.

A i drejtohet gjykatës dhe kërkon ribërjen e mbledhjes me të njëjtin rend dite, duke revokuar vendimin e datës 02.02.2014 të asamblesë, pasi si ortak i minorancës duhet të ushtrojë të drejtat e tij në shoqëri.

Jepni zgjidhjen tuaj mbi këtë rast.

Përgjigje:

Gjykata pranon padinë e A, pasi referuar nenit 15, 83 dhe 93 të ligjit për shoqëritë tregtare, rezulton se ortakut në minorancë është njoftuar mbi mbledhjen e Asamblesë në kundërshtim me nenin 83, nuk është respektuar afati 7 ditor si edhe forma e njoftimit. Gjithashtu nuk i janë vënë në dispozicion materialet përkatëse, pasi ligji nuk parashikon mënyrën e shprehur nga ortakut B, që A të paraqitet për shqyrtimin e dokumenteve në selinë e shoqërisë. Shkelja e nenit 15 mbi parimet e përgjithshme të së drejtës informimit si e drejtë themelore e ortakëve passjell cenim të kësaj të drejte dhe shkelje të nenit 93.

Ushtrimi 2

Një person kishte nisur punë në një kompani në muajin Maj 2020, për një pagë mujore bruto 90.000 lekë. Gjithashtu, ky person është i punësuar edhe në një kompani tjetër me një pagë mujore bruto 50.000 lekë. Llogarisni kontributet për sigurimet shoqërore që ky person dhe punëdhënësit e tij duhet të deklarojnë dhe derdhin për muajin Tetor 2020.

Zhvillim

Kompania 1

$90.000 \times 15\% = 13.500$ lekë (punëdhënësi)

$90.000 \times 9,5\% = 8.550$ lekë (punëmarrësi)

Kompania 2

$(114.670 - 90.000) \times 15\% = 3.700,5$ lekë (punëdhënësi)

$(114.670 - 90.000) \times 9.5\% = 2.343,65$ lekë (punëmarrësi)

Ushtrimi 3

A dhe B janë ortakë të shoqërisë "ZZ" shpk, ortakët janë me kuota të barabarta dhe B është dhe administrator. Pas vijimit të aktivitetit, pas 2 vjet nga krijimi, asambleja e ortakeve vendos mbylljen e aktivitetit tregtar dhe kalimin e shoqërisë në likuidim.

Pas 3 muajve A, i është drejtuar gjykatës duke kërkuar revokimin e vendimit për mbylljen e shoqërisë dhe vijimin e veprimtarisë tregtare duke argumentuar se shoqëria ka mundësi për të vijuar aktivitetin pasi ortakë B nuk ka pasqyruar të dhënat e sakta të shoqërisë në librat financiarë.

Jepni zgjidhjen tuaj.

Përgjigje:

Gjykata nuk e pranon këtë padi, padi në ligjin për shoqëritë tregtare nuk parashikohet që shoqëria që kalon në likuidim nuk mund të ndërpresë këtë status si shoqëri në likuidim dhe të vijojë aktivitetin tregtar si më parë. Vendimi i ortakëve ka qenë me unanimitet dhe si i tillë nuk ka vend për ta konsideruar të paligjshëm si vendim.

Ushtrimi 4

Një person, me pagë bruto 85.000 lekë, punon me turne pranë një shoqate bamirëse. Për muajin Qershor 2020, ky person kreu në total 3 turne të dyta në orarin 14:00-22:00 dhe 4 turne të treta në orarin 22:00-6:00. Llogarisni shtesën minimale të pagës që duhet të përfitojë ky person sipas dispozitave në fuqi.

Zhvillim

Llogaritet fillimisht paga orare: $85.000 : (22 \text{ ditë pune} \times 8 \text{ orë/dita}) = 483 \text{ lekë/ora}$

Shtesa për turnet e dyta

$3 \text{ turne} \times 3 \text{ orë (19:00-22:00)} \times 483 \times 20\% \text{ shtesa} = 869 \text{ lekë}$

Shtesa për turnet e treta

$4 \text{ turne} \times 8 \text{ orë (22:00-6:00)} \times 483 \times 50\% \text{ shtesa} = 7.727,3 \text{ lekë}$

$\text{Totali} = 869 + 7.727,3 = 8.596,4 \text{ lekë}$

Ushtrimi 5

Një punonjës e ka pagën bruto 150.000 lekë në muaj në kompaninë ku është i punësuar. Për muajin Shtator 2020, ky person nuk është paraqitur në punë për 8 ditë pune me raport mjekësor. Përlllogarisni detyrimet për sigurimet shëndetësore për këtë person.

Zhvillim

Paga ditore bruto = 150.000 lekë / 22 ditë pune = 6.818,2 lekë/dita

Ditë me raport të mbuluara nga punëdhënësi = 8 ditë pune x 6.818,2 lekë/dita x 80% = 43.636,4 lekë.

Paga për ditë të punuara gjatë Shtatorit = (22 – 8) x 6.818,2 lekë/dita = 95.454,55 lekë

Paga bruto mujore = 43.636,4 + 95.454,55 = 139.091 lekë

139.091 x 1,7% = 2.364,5 lekë (punëdhënësi)

139.091 x 1,7% = 2.364,5 lekë (punëmarrësi)

Ushtrimi 6

Debitori individ paraqet kërkesë për shkarkimin nga detyrimet e mbetura. Pas kësaj kërkesë kreditori kërkon refuzimin e shkarkimit të detyrimeve të mbetura duke e bazuar atë në faktin që 'debitori, nga pakujdesia, ka bërë deklarata të rreme ose të paplota në përpilimin e listës që kërkohet për të paraqitur pasuritë dhe të ardhurat e tij, kreditorët e tij dhe pretendimet ndaj tij'.

A është kjo një arsye bindëse për gjykatën e falimentimit për refuzimin e shkarkimit nga detyrimet e mbetura?

Pergjigje:

Po, në kuptim të nenit 158 të Ligjit nr.110/2016 'Per falimentimin' fakti që 'debitori ka bërë, me dashje ose nga pakujdesia, deklarata të rreme ose të paplota në përpilimin e listës që kërkohet për të paraqitur pasuritë dhe të ardhurat e tij, kreditorët e tij dhe pretendimet ndaj tij' përbën arsye për pranimin e kërkesës së kreditorit për refuzimin e kërkesës së debitorit.

Arsye të tjera për refuzim në kuptim të nenit 158 janë si më poshtë:

a) debitori është dënua për vepër penale me një vendim të formës së prerë, sipas dispozitave të Kodit Penal;

b) debitori, në 3 vitet e fundit nga data e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit ose pas kësaj kërkesë, qëllimisht ose nga pakujdesia, ka dhënë një deklaratë të rreme ose të paplotë me shkrim në lidhje me gjendjen e tij financiare, në mënyrë që të përfitojë një kredi, grante nga fondet publike ose të shmangë pagesat në favor të fondeve publike;

c) debitori është shkarkuar nga detyrimet e mbetura në 10 vitet e fundit që nga data e dorëzimit të kërkesës dhe ky shkarkim nga detyrimet është revokuar;

ç) debitori, në vitin e fundit që nga data e kërkesës për shkarkimin nga detyrimet e mbetura ose pas kësaj kërkesë, me dashje ose nga pakujdesia, ka dëmtuar shlyerjen e kreditorëve të falimentimit, duke krijuar detyrime të panevojshme përmes keqpërdorimit të pasurive ose duke vonuar fillimin e procedurës së falimentimit ose duke ulur mundësitë për të përmirësuar gjendjen e tij financiare;

d) debitori, me dashje ose nga pakujdesia, ka shkelur detyrimet e tij për të vënë në dispozicion informacionin ose për të bashkëpunuar gjatë procedurës së falimentimit.

Ushtrimi 7

Gjatë procedurës së falimentimit, administratori i përkohshëm gjendet në një rast urgjent ku për vazhdimin e funksionimit të veprimtarisë vendos të lejojë pagesë me përparësi pa miratim paraprak të gjykatës së falimentimit.

A është ky një veprim që bie ndesh me detyrat dhe kufizimet që ka administratori i përkohshëm?

Pergjigje:

Në kuptim të Ligjit Nr.110/2016, datë 27.10.2016 'Për falimentimin', administrator i përkohshëm mund të lejojë pagesën me përparësi pa miratim paraprak të gjykatës së falimentimit në raste urgjente, kur furnizimi i këtyre mallrave, shërbimeve dhe kredive është i domosdoshëm dhe kur miratimi i gjykatës së falimentimit mund të vonojë.

Në mënyrë që veprimet e administratorit të përkohshëm të mos bien ndesh me kufizimet e këtij neni dhe ligjit duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative të dyja kushtet thelbësore si vijon:

- 1. furnizimi i këtyre mallrave, shërbimeve dhe kredive është i domosdoshëm; dhe*
- 2. ky furnizim pëbën një rast urgjent që nuk mund të presë afatin e miratimit nga gjykata e falimentimit.*

Në kushte jo urgjente, miratimi i gjykatës së falimentimit jepet nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) përparësia është e nevojshme për vazhdimin e funksionimit të veprimtarisë;*
- b) furnizimi i këtyre mallrave, shërbimeve dhe kredive është i domosdoshëm;*
- c) është treguar se një veprim i tillë është në interesin më të mirë të kreditorëve dhe masës së falimentimit.*

Ushtrimi 8

Aksionerët e shoqërisë X, të cilët përfaqësojnë 5 % të kapitalit bazë, të parashikuar në statut, i kërkojnë Këshillit të Administrimit të kryejnë mbikëqyrje të veçantë për disa çështje të posaçme që lidhen me ligjshmërinë e veprimeve të administratorëve. Këshilli i Administrimit nuk e përmbush këtë kërkesë brenda afatit 30 ditor të përcaktuar sipas ligjit. Cila është procedura që ndiqet në vijim?

Pergjigje:

Procedura që ndiqet në këtë ushtrim është e përcaktuar në nenet e mëposhtme

Neni 150, 151, 165 (Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare)

Aksionarët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të kapitalit bazë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, apo kreditorët e shoqërisë, pretendimet e të cilëve ndaj saj janë të paktën sa 5 për qind e kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë këshillit të administrimit të kryejnë mbikëqyrje të veçantë për çështje të posaçme, sidomos kur merret në shqyrtim ligjshmëria e veprimeve të administratorëve.

2Nëse këshilli i administrimit nuk e përmbush kërkesën e përmendur në pikën 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve, aksionarët dhe kreditorët në fjalë mund të nisin procedurën e parashikuar në nenin 150 të këtij ligji.

Neni 150 Hetimet e posaçme

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të nisë një hetim të posaçëm për parregullsitë në veprimet e themelimit të shoqërisë dhe të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

2. Aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Aksionarët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e aksionarëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm, aksionarët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e ekspertit, kur ekzistojnë dyshime të bazuara se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur.

4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.

5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

6. Kreditorët që, në keqbesim, paraqesin kërkesa, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjen në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 151 Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës kompetente shfuqizimin e vendimeve të administratorëve e, sipas rastit, të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës, kur këto vlerësohen si shkelje të rënda të ligjit ose të statutit.

Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marre me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 145, të këtij ligji, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve e, sipas rastit, të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe/ose për ngritjen e padive të tjera, që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo anetareve të këshillit të administrimit a këshillit mbikëqyrës

2. Aksionaret, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë ose një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut, dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padise për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve ose anetareve të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës. Aksionaret apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padise, kanë të drejtë të ngrenë drejtperdrejt përpara gjykatës kompetente padi në emër të shoqërisë për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakeve apo kreditorëve të përcaktuar më sipër vlerësohet e refuzuar.

3. Në varësi të organit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, vendimi i të cilit paditet për shfuqizim, asambleja e përgjithshme merr pjesë në gjykim me anë të administratorëve, me anë të këshillit të administrimit apo

këshillit mbikëqyrës. Shoqëria mund të marrë pjesë në gjykim edhe nëpërmjet një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.


4. Aksionarët e pakicës ose kreditorët e përmendur në pikën 1 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, që nuk bën pjesë në organet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, kur ekzistojnë dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të ankimuar, nëse organi, që ka nxjerrë aktin e paditur, nuk merret vesh me pajtim me personin, që përfaqëson shoqërinë, sipas pikave 3 ose 4 të këtij neni, për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.

6. Aksionarët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen e padisë ndaj administratorëve apo anëtarëve të këshillave, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si pasojë e vendimit të paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera, që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve ose anëtarëve të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës.

Ushtrimi 9

Individët A, B, C, D dhe E kanë investuar kapitalet e tyre në shoqëritë tregtare private 1, 2 dhe 3, të cilat janë aksionere të shoqërisë XYZ, sipas skemës më poshtë:



Kërkohet: Të identifikohet klienti (dhe pronari i XYZ) dhe "përfituesit" e vërtetë të transaksionit.

Përgjigje:

Klienti është Shoqëria XYZ, një shoqëri private. Personat A, B, D apo E nuk ushtrojnë kontrollin përkatës përmes mjeteve të tjera (të tilla si kontrolli përmes 25% të të drejtave të votimit ose mjeteve të tjera të kontrollit) dhe bazuar në një prag të pronësisë 25%, pronari përfitues është personi C. Në përcaktimin e pronarëve përfitues, duhet të gjithashtu të dihet pronësia e shoqërive 1, 2 dhe 3 (gjithashtu shoqëri private), por ato vetë nuk plotësojnë përkufizimin e një pronari përfitues, pasi ato nuk janë individë.

Personi C: identifikohet si pronar përfitues për shkak të përqindjes indirekte të kuotës prej 27% që zotëron në shoqërinë XYZ nëpërmjet kuotave që zotëron në shoqërinë 2 dhe 3. [Llogaritja $70\% \cdot 35\% + 10\% \cdot 25\%$]

Ushtrimi 10

Një shoqëri investimesh mashtruese

Faktet e dhëna

Një shoqëri investimesh e sapo themeluar ("Shoqëria") kërkon shërbimet tuaja të kontabilitetit. Shoqëria drejtohet nga një grup këshilltarësh profesionistë shumë të paguar. Ata ju vunë në dispozicion dokumentet si më poshtë:

Dokumentet ligjore të themelimit të shoqërisë
Kopjet e pasaportave të ekipit drejtues
Fotografitë e ekipit të këshilltarëve profesionistë
Pamje të zyrave të tyre
Linkun e faqes së internetit

Gjatë procesit tuaj të rishikimit, keni zbuluar se Drejtori i Përgjithshëm drejton një biznes të ngjashëm e cila u kolapsua së fundmi pasi nuk arriti të publikojë pasqyrat financiare. Ajo që ishte më shqetësuese megjithatë, ishte paralajmërimi për mashtrim, i gjetur në internet, për një shoqëri tjetër me një emër të ngjashëm me klientin.

Në përpjekjen tuaj për të përfunduar të gjithë punën, ju kontaktoni këshilltarët profesionistë që përfaqësojnë klientin tuaj, duke kërkuar një CV të Drejtorit të përgjithshëm të cilën ata nuk mundën ta gjenin (ju nuk mund të gjeni diku tjetër info mbi Dr e Përgjithshëm të Shoqërisë). Për më tepër, kontabilistët e mëparshëm nuk kishin mundësi t'ju vinin në dispozicion informacione mbi shoqërinë klient.

Në një përpjekje të fundit për konfirmimin e ndonjë informacioni, ju kryqëzoni dhe kontrolloni fotografinë e zyrave me pamje të të ofruara me hartat google, vetëm për të gjetur ndonjë lidhje tjetër që të mund të informoheshit dhe nuk gjeni gjë.

Kërkohet:

1. Cilat janë 'flamujt e kuq' të identifikuar që mund të tregojnë aktivitetin e pastrimit të parave dhe / ose financimin e terrorizmit në këtë rast?
2. Cilat janë rreziqet dhe kërcënimet e mundshme me të cilat mund të ballafaqohet shoqëria e kontabilitetit në këtë situatë?
3. Çfarë pune në lidhje me vigjilencën dhe kujdesin e duhur mund të ketë kryer firma e kontabilitetit dhe kur?
4. Çfarë hapash mund të ndërmarë shoqëria e kontabilitetit për të zbutur rreziqet e saj dhe ekspozimin e mundshëm?

Pergjigje:

1. Cilat janë 'flamujt e kuq' të identifikuar që mund të tregojnë aktivitetin e pastrimit të parave dhe / ose financimin e terrorizmit në këtë rast?

- Drejtori i Përgjithshëm ka një historik të pajtueshmërisë së dobët me dhënien e informacionit financiar dhe shënimeve shpjeguese
- Këshilltarët profesionistë që përfaqësojnë Shoqërin nuk mundën të siguronin një CV të Drejtor të Përgjithshëm
- Kontabilistët e mëparshëm nuk mundën të vënë në dispozicion një referencë mbi shoqërinë
- Reklamë e pafavorshme për një shoqëri me emër të ngjashëm
- Mospërputhje në informacionin e dhënë për vendndodhjen e zyrave

Treguesit e mësipërm, të cilët dolën gjatë vlerësimit fillestar të rrezikut, do të duhet të hetohen më tej, përpara se angazhimit me këtë shoqëri investimesh.

2. Cilat janë rreziqet dhe kërcënimet e mundshme me të cilat mund të ballafaqohet shoqëria e kontabilitetit në këtë situatë?

- Reputacion i keq
- Gjobat administrative për mos ushtrimin e kujdesit të duhur
- Padi të mundshme ligjore nga investitorë të mashtruar
- Lehtësimi i Shoqërisë së Investimit për të pastruar fonde të mundshme të siguruara nga aktivitete të paligjshme (investime mashtruese)

3. Çfarë pune në lidhje me vigjilencën dhe kujdesin e duhur mund të ketë kryer firma e kontabilitetit dhe kur?

Kujdesi i duhur fillestar u krye si duhet. Pas gjetjeve, gjithsesi, procedurat duhet të vijojnë duke kërkuar:

- që letrat e referencës për anëtarët e ekipit drejtues, lëshuar nga Institucione të besueshme, të postohen drejtpërdrejt në zyrën tuaj;
- licencë për të operuar nga një rregullator i pranuar;
- shpjegim analitik të mënyrës si operon biznesi lidhur me (i) mënyrën si investitorët vendosin paratë e tyre dhe (ii) llojin e kujdesit të duhur që shoqëria po kryen për klientët e vet;
- vërtetimin e adresës së zyrës qendrore.

4. Çfarë hapash mund të ndërmarrë shoqëria e kontabilitetit për të zbutur rreziqet e saj dhe ekspozimin e mundshëm?

Nëse nga informacione shtesë që do të marrë, 'Flamujt e Kuq' ende ekzistojnë ose nuk janë trajtuar plotësisht, atëherë shoqëria e kontabilitetit duhet të konsiderojë refuzimin e marrëdhënies së biznesit.